

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

RAPORT I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

PËR VITIN 2017

Tiranë, 22 MAJ 2018

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Luan Muça
Vjollca Dervishi

Faqe 1 nga 16



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

I. INFORMACION JURIDIK DHE ORGANIZATIV

Emri : Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Statusi juridik : Organizatë jo fitimprurëse, rregullator i profesionit.

Selia : Rr. e Elbasanit, Pall Edil AI-It, kati 3, Tiranë.

Themeluar : Me vendim gjykatë nr 3573, datë 16 tetor 1998.

Themeluesit : Grupim profesional i Ekspertëve Kontabël dhe shoqërive të auditimit që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë : Të sigurojë ushtrimin e profesionit të Audituesit Ligjor në përputhje me Ligjin e zbatueshëm, në përputhje me interesat e publikut. Të mbrojnë pavarësinë dhe të nderin e antarëve të tij. Të garantojë formimin profesional të Audituesve Ligjor. Të rrisë njohjen dhe zbatimin e standarteve ndërkombëtare.

Organi më i lartë vendimmarrës : Asambleja e përgjithshme e antarëve.

Organi Drejtues : Këshilli Drejtues i zgjedhur nga Asambleja e përgjithshme, përbëhet nga:

- | | |
|----------------------|------------|
| 1. Hysen Çela | kryetar |
| 2. Eleonora Olli | nënkryetar |
| 3. Bujar Osmani | antar |
| 4. Shkëlzen Margjeka | antar |
| 5. Kledian Kodra | antar |
| 6. Doranin Agalliu | antar |
| 7. Arqile Mishtaku | antar |

Gjatë vitit 2017 Këshilli Drejtues është mbledhur 7 herë , dhe kostot e mbledhjeve kapin shifrën 744 000 lekë, ndërkohë që honoraret mujore të Këshillit Drejtues janë të miratuara nga Asambleja për një vlerë vjetore 3 000 000 lekë.

Organi Ekzekutiv : Drejtori i zgjedhur nga Këshilli Drejtues dhe miratuar nga Asambleja, Elvira Hoxha .

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

Organi Mbikqyrës : Bordi i Mbikqyrjes Publike i emëruar nga Ministri i Financave, organizimi i të cilit është rregulluar me VKM nr. 786 date 09.11.2016 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të antarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të BMP".

Organe bashkvepruese :

1. **Autoriteti i Regjistrimit pranë IEKA-s**, i cili përbëhet nga 5 antarë të cilët emërohen nga Ministri Përgjegjës për Ekonominë, organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të nenit 19,60 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar dhe dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 874 datë 12.08.2009, me Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Regjistrimit pranë IEKA, të propozuar nga IEKA dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.
Gjatë 2017 ky autoritet është mbledhur vetëm një herë në 30/01/2017 dhe ka kushtuar vetëm 44 500 lekë.
2. **Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP)**, i cili përbëhet nga 5 antarë të cilët emërohen nga Bordi i Mbikqyrjes Publike për një periudhë katër vjeçare. KPAP është krijuar në vitin 2018, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.
Struktura përgjegjëse për financën pranë Bordit të Mbikqyrjes Publike mban regjistrime të veçanta të arkëtimeve e pagesave që lidhen me veprimtarinë e KPAP.
Përgjatë vitit 2017 nuk funksionoi Autoriteti i Çertifikimit pranë IEKA-s, i cili u zëvendësua në 2018 me KPAP.
3. **Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës**, i cili përbëhet nga :
 - Shkëlzen Margjeka kryetar
 - Teki Flamuri antar
 - Elton Tirana antar

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të neneve 5,12,14,55,57 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 te ndryshuar me Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.
Gjatë vitit 2017 ky komitet është mbledhur 5 herë dhe ka kushtuar 249000 lekë.

4. Komiteti i kontrollit të cilësisë, i cili përbëhet nga

- Eleonora Olli kryetar
- Arqile Mishtaku antar
- Afrim Suli antar
- Fatime Alliu antar

organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të nenit 38 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 te ndryshuar dhe nenit 15 të Statutit të IEKA-s, me Rregulloren për Kontrollin e Cilësisë, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

Gjatë vitit 2017 ky komitet është mbledhur 5 herë dhe ka kushtuar 145000 lekë.

5. Komiteti i Edukimit Profesional, i cili përbëhet nga:

- Kledian Kodra kryetar
- Ana Osmani antar
- Diana Lamani antar

organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 te ndryshuar dhe të Statutit të IEKA-s, me Rregulloren e edukimit dhe kualifikimit profesional, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të aprovuar nga Asambleja e përgjithshme e antarëve.

Gjatë vitit 2017 ky komitet është mbledhur 7 herë dhe ka kushtuar 175000 lekë.

6. Komiteti i Kualifikimit të vijueshëm, i cili përbëhet nga:

- Doranin Agalliu kryetar
- Ludmilla Paluka antar




INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

-
- Armand Fehtahaj antar
- organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 të ndryshuar dhe të Statutit të IEKA-s, me Rregulloren, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të aprovuar nga Asambleja e përgjithshme e antarëve.
7. Komitetei i Etikës, i cili përbëhet nga :
- Bujar Osmani Kryetar
8. Komiteti i kontrollit të brendshëm, i cili përbëhet nga Luan Muca dhe Vjollca Dervishi. Kostoja vjetore e këtij komiteti kap vlerën 180000 lekë.

Në bazë të Statutit të IEKA-s detyrat e kontrollit të brendshëm janë sipas nenit 25 :

- 25.1 Të verifikojë veprimtarinë financiare të Institutit , të kontrollojë dhe mbikëqyrë zbatimin e procedurave kontabël , pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara në llogari me buxhetin si dhe rregullsinë dhe korrektesën e llogarive vjetore të aprovuara nga Këshilli Drejtues .
- 25.2 Të propozojë ekspertin kontabël të regjistruar i cili do të auditojë pasqyrat financiare të Institutit dhe të mbajë marrëdhëniet ndërmjet tij dhe personelit të Institutit .
- 25.3 Bën vlerësimin e situatës financiare të Institutit , bazuar në raportin e ekspertit kontabël të regjistruar ;
- 25.4 I jep mendimin Këshillit Drejtues për të gjitha problemet që i kërkojnë prej këtij të fundit ;
- 25.5 Komiteti i Kontrollit të brendshëm i paraqet Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve një raport vjetor që nënshkruhet bashkërisht nga anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm . Në rast mosmarrëveshje secili anëtarë paraqet veçmas mendimet dhe vlerësimet e tij në Asamblesë të Përgjithshme të Anëtarëve , e cila merr vendimin përfundimtarë në lidhje me çështjen .

II. VEPRIMTARIA FINANCIARE E IEKA



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

Veprimtaria e IEKA-s rregullohet me ligjet :

- Ligjin "Për tregtarët e shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.
- Ligjin nr 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" te ndryshuar me ligjin 47/2016.
- Ligjin për "Organizatrat jo-fitimprurëse" dhe
- Statutin e IEKA-s.

Veprimtaria e IEKA-s konsiston në ndihmesën që u jepet profesionistëve në lidhje

me ushtrimin e profesionit në përputhje me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të antarëve të tij, kualifikimin e vijueshëm profesional, në njohjen me standartet ndërkombëtare.

Kjo ndihmesë iu jepet përkundrejt kuotës vjetore që secili prej antarëve pagan. Konkretisht Për vitin 2017 kuotat janë si më poshtë:

1. Kuota fikse 100 000 lekë për çdo antarë aktiv në profesion.
2. Kuota fikse 8 000 lekë për çdo antarë joaktiv në profesion
3. Kuota variabël 0,5 % të vlerës së përfutur nga misionet ligjore

Të ardhurat nga kuotat e ndryshme apo trajnimet e realizuara shërbejnë për të mbuluar shpenzimet , të cilat nevojiten për të mbuluar kuotat për pjesmarrje në organizma ndërkombëtar, për mbajtjen e personelit dhe për mbulimin e kostove të shërbimeve që IEKA merr nga të tretët në kryerjen e veprimtarisë së vet.

Veprimtaria e IEKA-s realizohet nëpërmjet organeve drejtuese dhe ekzekutive. Për të realizuar një veprimtari në përputhje të plotë me Ligjet rregullatore Organet drejtuese të saj kanë realizuar një rregullore të brendshme , ku përcaktohen me hollësi detyrat dhe përgjegjësit e secilit pozicion pune.

Më poshtë po permendim funksionet e Sektorit të Financë kontabilitetit shkurtimisht, meqënëse edhe detyra e KKB fokusohet tek ky sektor:

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

- Sektori i Financë kontabilitetit përbëhet nga një person Alida Daija dhe detyrat kryesore janë :

I paraqet Drejtorit treguesit e projekt buxhetit sipas aktiviteteve.

Llogarit kostot sipas aktiviteteve.

Llogarit pagat dhe honoraret e miratuara nga Këshilli Drejtues.

Mban librat e llogarive dhe realizon kontabilizimin e dokumentacionit.

Llogarit dhe përpilon pagesat e bëra të tretëve.

Mban rregjistrat e punonjësve.

Përgatit dhe analizon raportet financiare mujore , tremujore e vjetore

dhe ia paraqet Drejtorit.

Kontrollon veprimet e arkës.

Rakordon kontributet e secilit antar me deklaratimet e tyre.

Përgatit Pasqyrat financiare vjetore.

Informon për gjendjen financiare edhe Kryetarin e KD.

III. PROÇEDURAT KONTABEL

Organi Ekzekutiv i IEKA-s ka ndërtuar sistemin e regjistrimeve në kontabilitet, sipas parimeve dhe metodave të njohura kontabël, të cilat janë në përshtatje me Ligjin "Për Kontabilitetin" si dhe në funksion të dhënies së informacioneve mbi realizimin e zërave të parashikuara në buxhetin e miratuar.

Kryerja e shpenzimeve realizohet mbi bazën e domosdoshmërisë së tij, me qëllimin e përdorimit sa më me efektivitet të burimeve.

Çdo shpenzim shoqërohet me dokumentacion bazë justifikues , autorizohet dhe miratohet nga personat përgjegjës.

Drejtori ekzekutiv autorizon shpenzimet e buxhetuara si dhe veprimet që lidhen me pagesat apo tërheqjet nga llogaritë bankare të IEKA-s, brenda kufijëve të përcaktuar nga këshilli i Drejtimit.

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

Blerjet e mëdha gjatë 2017 (rikonstruksion pjesor i ambienteve të zyrave (wc)) janë realizuar me miratimin e Këshillit Drejtues.
Blerjet me lekë në dorë verifikohen nga Financieri dhe paguhen nga Arkëtari dhe në çdo rast kanë 3 firma.
Organet ekzekutive planifikojnë që në fillim të vitit buxhetin për blerjen e çdo lloji pajisje, materiali apo shërbimi.
Çmimet e materialeve të trajnimit apo të çdo shërbimi tjetër që iu bëhet antarëve të Institutit apo edhe të tretëve, përlogariten për çdo shërbim më vehte.
Financieri ndjek arkëtimin e kuotave fikse dhe variabël të antarëve si edhe të të ardhurave të tjera si kurse trajnimi, regjistrime të reja, botime, e të tjera.

IV. PAJTUESHMËRIA E LLOGARIVE ME BUXHETIN


Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar realizimi i buxhetit për vitin paraardhës, Buxheti i planifikuar për vitin 2017 dhe realizimi i tij në vlerë absolute dhe në përqindje përkundëjt buxhetit të planifikuar :

Realizimi i Buxhetit 12M 2017

Zerat e Buxhetit		Realizimi Buxhetit 2016	Buxheti i miratuar 2017	Realizimi Buxhetit 12M 2017	% ndaj Buxhetit
1	Burimet	34,194,711	30,750,000	31,782,831	103
1.1	Burime financiare	30,347,323	27,750,000	29,031,504	105
	Kuota fikse e anetaresimit	22,252,780	22,100,000	21,268,663	96
	Kuota variable e misionëve	3,899,444	3,250,000	4,347,337	134
	Te ardhura nga regjistrimi kandidatëve	2,550,000	1,500,000	950,000	63
	Te ardhura të tjera	1,645,099	900,000	1,366,692	152
	Sponsorizime Konferenca 20 vjetori			1,098,812	

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

1.2	Burime te ardhurash te tjera	3,847,388	3,000,000	2,751,327	92
	Burime (te ardhura) nga Botimet	219,800	500,000	11,000	2
	Burime (te ardhura) kualif kandidate	1,565,500	1,400,000	1,505,500	108
	Burime (te ardhura) nga kualif AL	219,000	300,000	182,000	13
	Burime nga trajnimi i SKK/SNK	626,000	600,000	568,000	189
	Te ardhura nga depozitat e kursimeve	1,113,370	200,000	378,652	63
	Fitime/humbje kursi kembimit	103,718		106,175	
2	Perdorime (Shpenzime)	30,238,121	38,232,000	30,734,092	80
2.1	Shpenzime nga veprimtaria	21,757,313	34,562,000	27,663,774	416
2.1.1	Pagat e punonjesve	4,807,985	8,350,000	5,592,610	67
	Pagat e personelit me kohe te plote	3,579,275	7,400,000	4,259,891	58
	Sigurime shoqerore	469,650	950,000	552,719	58
	Pagat personeli me kohe pjeseshme	759,060		780,000	
2.1.2	Honorare te Drejtimit	3,813,000	4,152,000	3,924,000	95
	Honorare Ant KD & Drejtimi perditsh.	3,000,000	3,000,000	3,000,000	100
	Pagese per mbledhje te KD	633,000	972,000	744,000	77
	Komiteti i Kontrollit te Brendshem	180,000	180,000	180,000	100
2.1.3	Honorare per Autoritete e Komitete	1,903,760	3,430,000	1,023,712	30
	Autoriteti i Regjistrimit	209,000	400,000	44,500	11
	Komiteti i Investigimit & Disiplines	376,000	400,000	249,000	62
	Komiteti i Edukimit te Kandidateve				35




INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

	280,000	500,000	175,000	
Komiteti i Kualifikimit te Vijueshem	22,000	250,000	81,000	32
Komiteti i Kontrollit te Cilesise	1,005,000	1,280,000	145,000	11
Komiteti perkthim rishikim te Stand. Prof		500,000	263,212	53
Komiteti i Etikes dhe te tjera		100,000	66,000	66
Bordi i Mbikqyrjes Publike	11,760			
2.1.4 Shpenzime te Administrimit	10,465,158	16,330,000	15,048,163	92
Telefon, Fax, shpenzime interneti	319,293	450,000	221,405	37
Mirembajtja e regjistrit publik & faqes inter.		200,000	117,600	59
Energji, Uje.	232,010	300,000	167,510	56
Kancelari, Shtypshkrime, riparime	364,909	350,000	216,960	62
Reklama, Publicitet, Njoftime		50,000		0
Abonime, Gazeta, revista		50,000		0
Udhetime e Djeta	2,027,186	2,200,000	1,891,456	86
Karburant e rip. te zakonshme	243,850	300,000	125,288	42
Taksa, sigurime e parkim automjetesh	165,307	250,000	230,584	92
Shpenzime pritjeje	118,670	250,000	127,299	51
Sherbime ne te trete	438,730	550,000	452,557	82
Regjistrime në organet lokale	40,930	80,000	40,930	51
Shpenzime per kom. Bankare	82,106	100,000	94,940	95
Kuota anetaresimi Org. Nd/kombetare	2,003,850	2,000,000	1,849,311	92
Shpenzime te tjera				112


Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Luan Muça
Vjollca Dervishi

Faqe 10 nga 16



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

		590,042	500,000	559,936	
	Shpenzime per Asamblene	1,016,500	2,000,000	680,950	34
	Shpenzime Konferenca 20 Vjetori		3,000,000	4,706,207	157
	Auditimi i PF	165,948	200,000	162,012	81
	Shpenzime amortizimi	1,988,913	3,500,000	2,013,218	58
	Shpenzime per provizione	581,794			
	shpenzime te paparashikuara	85,120		1,390,000	
2.1.5	Investime, Meremetime	667,410	2,000,000	1,975,289	99
	Investime (blerje AAM), meremetime	667,410	2,000,000	1,975,289	99
2.1.6	Rezerve e KD gjithsej	100,000	300,000	100,000	33
2.2	Shpenzime per botime	63,284	920,000	132,517	14
	Botimi i Revistes	39,194	620,000		0
	Shpenzime per botime te tjera	24,090	300,000	132,517	
	Shpenzime Adoptimi, perkthimi dhe pershtatja - Programi Pack PEE				
2.3	Shpenzime per kualifikimin	2,912,296	2,750,000	2,904,514	106
	Shpenzime kualifikimi kandidate	1,341,820	1,100,000	1,321,050	120
	Shpenzime kualifikimi AL	1,183,476	1,200,000	1,228,496	102
	Shpenzime trajnimi i SKK/SNK	387,000	450,000	354,968	79
2.4	Fitime/humbje kursi kembimit	2,978		33,287	
2.5	Aktiviteti sipas vendimit Asamblese	5,502,250			



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

3.1	Teprica nga veprimtaria kryesore	8,590,010	-6,812,000	1,367,730
3.2	Teprica nga Publikimet	156,516	-420,000	-121,517
3.3	Teprica nga kualifikimi AL & Kandidate	-501,796	-450,000	-649,014
3.4	Teprica nga depozitat e kursimeve	1,113,370	200,000	378,652
3.5	Teprica nga kursi i kembimit	100,740	0	72,888
Teprica total		3,956,590	-7,482,000	1,048,739
Teprica total perfshire Investimin		4,624,000	-5,482,000	2,040,200

Sikurse vihet re Burimet financiare nga aktiviteti janë realizuar krahasimisht me parashikimin në masën 105 %. Kanë ndikuar ndjeshëm në këtë rritje Të ardhurat nga kuota variabël e misionëve të cilat janë realizuar në masën 134 %, të ardhura të tjera në masën 152 %, të cilat krahasimisht me një vit më parë janë planifikuar në 54 % të realizimit të 2016, duke evidentuar rritje në raport me planifikimin por rënie në raport me realizimin e një viti më parë. Pra, parashikimi që do të kishte rënie ka qënë korrekt, pavarësisht saktësisë. Ndërkohë që ka pasur mosrealizim në kuotat fikse të antarëve, realizimi ka qënë vetëm 96 %, si dhe në të ardhurat nga regjistrimi i kandidatëve i cili është realizuar vetëm 63 %. Masa e realizimit të këtyre zërave krahasimisht me buxhetin, si edhe me një vit më parë tregon ecuri të mirë në aktivitetin e IEKA-s.

E kundërta ka ndodhur me realizimin e zërave të shpenzimeve, që në totalin e vet janë realizuar vetëm 80 % e shpenzimeve të buxhetuara. E njëjta përqindje kjo si një vit më parë, që do të thotë jemi treguar dorëlëshuar në buxhetim dhe dorështrënguar në shpenzimet e kryera. Kjo situatë na lë detyrën për të qënë më të kujdesshëm që në buxhetim.

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Luan Muça
Vjollca Dervishi

Faqe 12 nga 16

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

- Vërehet që shpenzimet për Paga e shtesa janë buxhetuar 42 % më shumë se sa realizimi, që do thotë se nuk është shtuar personeli me njerzit që u menduan që në buxhetim.
- Kostot e bëra për Honoraret e autoriteteve dhe Komiteteve janë shumë të ulta në krahasim me buxhetin dhe kjo vjen si rezultat i disa ndryshimeve që ndodhën në 2017 në nevojën e funksioneve të tyre, si për shembull minimizimi i realizimit të kontrollit të cilësisë (ndërprerjes së tij).
- Shpenzimet për botimet janë realizuar vetëm 14 % në raport me buxhetimin. Ishte planifikuar që do të kishim botimin e revistës por nuk u realizua.

Rritje e shpenzimeve shihet në pak zëra, dhe konkretisht:

- Shpenzime për konferencën e 20 vjetorit të IEKA-s ishin buxhetuar 3 000 000 lekë dhe u harxhuan 4 706 207 lekë ose 157 %, por nevoja e rritjes së këtij fondi u shoqërua me një Vendim të Këshillit Drejtues që në 20/09/2017, në rritje të shpenzimeve për këtë qëllim për një shtese prej 2 000 000 lekë. Kështu që realizimi i këtij zëri rezulton në masën 94 %.
- Shpenzime të paparashikuara janë kryer në ndihmë të antarëve prej 1 390 000 lekë, për të cilën ka vendosur asambleja në qershor 2017.
- Shpenzime për kualifikimin janë realizuar 106 % në raport me buxhetimin

V. KORREKTËSIA E LLOGARIVE TË APROVUARA NGA KD

Pasqyrat financiare të vitit 2017, të evidentuara më 31.12.2017 janë Hartuar nga Financiere Alida Daija, janë autorizuar nga Drejtori Ekzekutiv Elvira Hoxha dhe janë audituar nga Auditues Ligjor znj. Rajmonda Reveli e caktuar me këtë mision me Vendim Asambleje, e cila arriti në opinionin:

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Luan Muça
Vjollca Dervishi

Faqe 13 nga 16

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

"Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të IEKA më 31 dhjetor 2017 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme e Antarëve të cilat janë bazuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe veçanërisht në Standartin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF)."

Pasqyrat financiare 2017 janë autorizuar nga Këshilli Drejtues dhe nënshkruar në emër të tij nga Kryetari Z. Hysen Çela.

VI. VLERËSIMI I SITUATËS FINANCIARE

Sikurse shihet në pasqyrat financiare Aktivët e evidentuara kapin vlerën 124 827 463 lekë nga 125 297 552 lekë që kanë qënë një vit më parë, nga të cilat 11 577 522 lekë janë detyrime, duke lënë diferencën prej 113 249 941 lekë në Aktivët Neto, ndërkohë që rezultati vjetor shënon tepriç burimesh në ritje të Aktiveve neto në vlerën prej 2 040 200 lekë.

Burimet e krijimit të këtyre aktiveve rezultojnë të jenë në masën 90,7 % të IEKA-s dhe 9,3 % janë detyrime ndaj të tretëve. Detyrim ndaj Autoritetit të Çertifikimit ka mbetur e pandryshuar krahasimisht me një vit më parë, duke kapur shifrën 6 755 739 lekë ose 58,3 % të detyrimeve. Se si do të veprohet me këtë detyrim, tani që Autoriteti i Çertifikimit nuk funksionon më, duhet të shprehet Këshilli Drejtues.

KONSTATIME

- I. Gjate kontrollit të shpenzimeve për vitin 2017 nuk u konstatuan vërejtje për procedurat e blerjeve.

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Luan Muça
Vjollca Dervishi

Faqe 14 nga 16

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

2. Regjistrimet kontabël mbahen në Programin informatik "Alpha", duke mundësuar raportimin financiar direkt nga programi, pa ndihmesën e tabelave në exel.
3. U konstatua se ka Debitorë (antarë të IEKA-s) që nuk kanë likujduar detyrimet e tyre, dhe megjithë punën e bërë nga administrata (u verifikuan email-et e dërguara debitorëve për këtë qëllim) mbeten akoma debitorë ndaj institutit. Gjendje debitorësh në datën 31/12/2017 rezultojnë për kuotën variabël (ilogaria 411) 3 620 148 lekë, dhe për kuotën fikse plus penalitetet e vonesave (ilogaria 467) detyrimet e pashlyera shkojnë 4 379 401 lekë. Nënvizojmë se sjellja neglizhente e antarëve debitorë nuk është korrekte jo vetëm me rregulloren e funksionimit të institutit, por as etike në lidhje me antarët e tjerë që janë më se korrekt në këtë drejtim.

REKOMANDIME

1. Shërbimet nga Instituti çdo antar i merr në mënyrë të barabartë, prandaj edhe në likujdimin e detyrimeve duhet të jemi të barabartë dhe të përgjegjshëm.
Bazuar në Statutin e IEKA-s, kapitulli VII, pika 29.4 ku thuhet " Në rast të mospagimit të kuotës për një periudhë për më shumë se 6 muaj, KD ka të drejtë ti propozojë Bordit të Mbikqyrjes Publike, pezullimin e Audituesit Ligjor nga Regjistri Publik", duhet që Ekzekutivi i Institutit jo vetëm të punojë për mbledhjen e detyrimeve, por të dalë me propozime masash për antarët që nuk paguajnë kuotën.
2. Të shfrytëzohet fondi për botime. Asnjëherë nuk është e tepërt (edhe kur kalohet në përsëritje) që antarët të marrin informacion dhe njohuri teorike e praktike të herëpashershme dhe të përdituara në lidhje me aplikimin në praktik të Standarteve Kombëtare e ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Auditimit, në lidhje me kuptimin e ligjeve në përdorim, në lidhje me problematikat që ndeshen në interpretimet ligjore.
3. Të vijoj botimi i Revistës, jo vetëm për tejçimin e njohurive profesionale, por edhe për të shkëmbyer eksperiencë mes kolegësh.... etj.

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport I Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2017

PROPOZIME

Duke qënë se Burimet vjetore të veprimtarive të Institutit arrijnë të mbulojnë shpenzimet e nevojshme dhe teprica e krijuar përgjatë viteve vijon të ruajë gjendjen e likuiditeteve edhe në fund të vitit 2017 për mbi 78 milion lekë , pra më shumë se dyfishi i kostove vjetore mendojmë se një pjesë e vlerave të trashëguara (pa prekur vlerat e krijuara nga burimet e vitit në vazhdim) mund të përdoret në favor të të gjithë antarëve në mënyra të ndryshme :

Për këtë ne dalim me propozim për :

- Të studjohet konkretisht mundësia e blerjes / bërjes së një programi informatik Auditimi në ndihmesë të cilësisë së punës së çdo antari, duke menduar që ky program të mbetet aset i Institutit dhe çdo antar të pajiset me llogarinë e vet të përdorimit të tij.
- Zhvillimin e një aktiviteti turistik , pasi mendojmë se i shërben antarëve të njihen më mirë mes tyre dhe pse jo të bashkrendojnë jo vetëm kënaqësitë turistike por edhe bashkveprime të mundshme në aktivitetin e tyre.
- Organizimin e një ceremonie modeste nderimi për kontributin e dhënë prej tyre , për rastet e daljes në pension të antarëve.

PËR KOMITETIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Luan Muça

Vjollca Dervishi



Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Luan Muça
Vjollca Dervishi